



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

Nr. Prot. 1707 Dt 01.10.2021

Senati i Universitetit “Isa Boletini në Mitrovicë, bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 166, paragrafin 4 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Rregullores nr. 1667, dt. 29.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2021, vendosi të:

**Shpall**  
**KONKURS**

***Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit “Isa Boletini”***

**I. Fakulteti i Gjeoshkencave**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e gjeoteknologjisë, Mekanika e shkëmbinjve I, Mekanika e shkëmbinjve II, Gjeostatistika në miniera.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Siguria dhe ruajtja e ambientit, Ekonomia në miniera, Teknikat e sigurimit në miniera, Menaxhimi i minierave, investimeve dhe inxhinieria ekonomike.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Metalurgjia e hekurit dhe çelikut, Sigurimi i cilësisë në metalurgji, Teknologjitë bashkëkohore të prodhimit të çelikut, Riciklimi i materialeve.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia e materialeve në miniera, Hapja dhe përgatitja e vendburimeve, Projektimi në miniera.
5. Një mësimdhënës për lëndët: Elektro me hidrometalurgji, Metodatat bashkëkohore të prodhimit Pb dhe Zn, Proceset e avancuara të përpunimit të metaleve në gjendje të lëngët, Metalurgjia e pluhurit.
6. Një asistent për grup lëndësh në Metalurgji dhe Materiale.
7. Një asistent për grup lëndësh në Xehetari.

**II. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore;**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Matematika I, Matematika II.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Fiziologjia e mikroorganizmave industrialë, Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore, Teknologjia e verës, Inxhinieria enzimatiqe, Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve.

**III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Grup lëndësh nga informatika inxhinierike.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Qarqe kompjuterike, Komponentet elektronike, Elektronika digjitale, Simulimet me kompjuter, Automatizimi i prodhimitarisë dhe robotika.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia e përgjithshme e materialeve, Vizatim teknik me gjeometri deskriptive, Teknikat matëse, Vizatim me kompjuter, Softuer aplikativ.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhimi i projekteve; Menaxhimi i avancuar i projekteve, Ndërmarrësia, Menaxhimi i projekteve; Menaxhim, Menaxhim strategjik.
5. Një mësimdhënës për lëndët: Auditim, Bazat e ekonomisë në inxhinieri, Parimet e kontabilitetit, Menaxhim, Ekonomia ndërkombëtare; Menaxhimi i transportit.
6. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II.

7. Një asistent për lëndët: Matematika I dhe II.
8. Një asistent për Grup lëndësh nga Makinaria.
9. Një asistent për Grup lëndësh nga makinaria prodhuese.
10. Një asistent për Grup lëndësh Informatika.
11. Një asistent për Grup lëndësh informatika inxhinierike.
12. Një asistent për Grup lëndësh nga Ekonomia.

#### **IV. Fakulteti Ekonomik**

1. Një mësimsdhënës nga fusha e Menaxhmentit për lëndët: Makroekonomia, Parimet e Marketingut, Ndërmarrësi, Menaxhimi kulturor.
2. Një mësimsdhënës nga fusha e Menaxhmentit për lëndët: Mikroekonomi, Menaxhimi i NVM-ve, Menaxhimi i resurseve humane, Menaxhimi i riskut dhe sigurimeve.
3. Një asistent për Grup lëndësh në fushën e Menaxhmentit.
4. Një asistent për Grup lëndësh në fushën e Financa dhe Kontabilitet.
5. Një asistent për Grup lëndësh në fushën e Ekonomiksit.

#### **V. Fakulteti i Edukimit**

1. Një mësimsdhënës për lëndët: Matematika elementare I, Matematika elementare II, Metodologjia e mësimit të matematikës I, Metodologjia e mësimit të matematikës II.
2. Një mësimsdhënës për lëndët: Shkenca shoqërore në arsimin fillor, Shkenca shoqërore në edukimin parashkollor, Edukatë qytetare, Shkolla dhe komuniteti.
3. Një mësimsdhënës për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Histori e letërsisë kombëtare, Letërsi për fëmijë, Metodologji i leximit letrar.
4. Një mësimsdhënës për lëndët: Metodologji e përgjithshme me praktikë, Praktika pedagogjike II me metodologji, Teoria e mësimit, Shkathësitë e mësimit akademik.
5. Një asistent për lëndët: Hyrje në psikologji, Puna me fëmijë të talentuar, Psikologji edukimi, Psikologji e personalitetit, Psikologji zhvillimore.
6. Një asistent për lëndët: Shkencat natyrore në arsimin fillor I, Bazat e shkencave natyrore në edukimin parashkollor II, Bazat e shkencave natyrore në arsimin parashkollor I, Shkencat natyrore në arsimin fillor II, Eksperimenti në fëmijërinë e hershme, Edukim mjedisor.
7. Një asistent për lëndët: Matematika elementare I, Matematika elementare II, Metodologji e mësimit të matematikës I, Metodologji e mësimit të matematikës II, Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme, Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme.
8. Një asistent për lëndët: Filozofi e edukimit, Metodologji e përgjithshme me praktikë I, Praktika pedagogjike II me metodologji, Menaxhimi i klasës, Tendencat bashkëkohore në arsim, Vlerësim në arsim, Bazat e hulumtimit në edukim, Bazat e hulumtimit në arsim.
9. Një asistent për lëndët: Praktikë Pedagogjike me Metodologji III, Zhvillim i Kurrikulave, Praktika pedagogjike, Teori e mësimit, Zhvillim i kurrikulave, Zhvillimi profesional i mësimsdhënësve dhe portfoliot.
10. Një asistent për lëndët: Histori kombëtare, Historia e arsimit kombëtar, Edukatë qytetare.

#### **1. Kushtet e përgjithshme**

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë (UIBM), dhe Rregullores nr. 1667, dt. 29.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM.

#### **2. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) kërkesën për aplikim,
- b) biografinë (CV),

- c) certifikatën e lindjes,
- d) diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (baçelor, master/magjistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri.
- e) kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për emërim, riemërim ose avancim duhet të sjellin vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë).
- f) kandidatët që konkurrojnë për asistentë, lektorë dhe korepetitorë duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve baçelor dhe master/magjistraturë,
- g) kandidatët që janë të punësuar në UIBM duhet të paraqesin vendimin e emërimit të fundit. dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UIBM dhe Rregulloren në fuqi për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancimit të personelit akademik.
- h) dëshmi të lëshuar nga Gjykata Themelore përmes së cilës dëshmojnë që nuk janë të dënuar apo që nuk janë nën hetime.
- i) informatat e tjera specifike shitesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë, dhe
- j) deklaratë me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi i punës paraprak në rast të zgjedhjes nga Senati.

### **3. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim**

1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit dhe Rregullores në fuqi për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancimit të personelit akademik të UIBM.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitat.
3. Anëtarët e personelit akademik të cilët sipas Ligjit NR. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 443/005 dt. 31.03.2017, pika 3, 4 dhe 5 kalojnë në pozitën e bashkëpunëtorëve të jashtëm ose obligohen që të pezullojnë vendin e punës, gjatë periudhës që ushtrojnë poste publike dhe nuk kanë të drejtë t'i nënshtrohen procedurave të konkursit të rregullt për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim.
4. Në kuptim të zbatimit të vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 443/005 dt. 31.03.2017, kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UIBM, nëse janë të punësuar në ndonjë institucion publik apo privat, ndërmarrje publike apo private brenda apo jashtë vendit dhe/apo persona tjerë juridik të cilësdo fushëveprimtari apo status ligjor obligohen që para se të nënshkruajnë kontratë pune me UIBM të sjellin dëshmi për dorëheqje të parevokueshme nga vendi i punës paraprak, në të kundërtën të njëjtit nuk do të mund të nënshkruajnë kontratë pune me UIBM.
5. Kriteri i moshës së përcaktuar si në nenin 171 të Statutit vlen për kandidatët, të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e mbylljes së afatit për aplikim në konkurs. Nëse një (1) kandidat ka qenë i angazhuar në UIBM në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 171 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
6. Në UIBM nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidateve brenda ndonjë prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
7. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

### **4. Vendimi, periudha e ankimit dhe e përmbylljes së konkursit**

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e këshillit të fakultetit lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik bëhet sipas rregullores së punës së Senatit.
2. Anëtarë i personelit akademik, i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, mbetet në thirrjen e njëjtë.
3. Ndaj vendimit të Senatit, në afat jo më larg se 15 ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashpresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UIBM.
4. Pala ankuese pasi t'i shterë mjetet juridike të punëdhënësi, në këtë rast në UIBM, sipas ligjit për zyrtarët publikë mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
5. Konkursi për zgjedhje, rizgjedhje ose avancim të personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UIBM për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
6. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumi 30 ditë.
7. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si paragrafin 5 të këtij kapitulli, atëherë vendet përkatëse të porealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës, sipas kërkesës së fakultetit.

#### 5. Mënyra e aplikimit

1. Konkursi publikohet në web-faqen zyrtare [www.umib.net](http://www.umib.net).
2. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
3. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në platformën on-line të UIBM linku: [konkursi.personeliakademik2021@umib.net](mailto:konkursi.personeliakademik2021@umib.net)
4. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra dhe monografi të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
5. Dorëzimi fizik i aplikacioneve dhe aplikimi përmes platformës on-line do të fillojë nga data 01.10.2021 deri më 18.01.2021.
6. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.
7. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit, përkatësisht nga data 01.10.2021 deri më 18.01.2021 ora 16:00.

